

20182203845

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM PENSIONAL DHE INVALIDOR

Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16 dhe 35/18), në nenin 11 paragrafi (1) në pikën 9) pas fjalës "profesion" shtohen fjalët: "deri në moshën 64 vjeçare".

Në pikën 14) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhëzën "dhe" dhe shtohet pikë e re 15), si vijon:

"15) person fizik i cili është i regjistruar si kryerës i veprimtarisë së pavarur për tregti me pakicë në tezga dhe tregje, i regjistruar në regjistrin e Odës së Tregtarëve të Maqedonisë nëse nuk është i siguruar në asnjë bazë tjetër."

Në paragrafin (2) pas numrit "9" vihet presje, kurse fjalët: "dhe 14" zëvendësohen me fjalët: "14 dhe 15".

Neni 2

Në nenin 19 paragrafi (2) fjalët: "në vende të punës dhe punë të cilat bëhen nën tokë dhe i cili gjatë sigurimit ka qenë i sistemuar në punë dhe vende pune me shkallë të ndryshme të rritjes së stazhit të sigurimit" shlyhen.

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) I siguruari të cilit 12 muaj efektive stazh të kaluar të sigurimit i llogaritet si stazh sigurimi me kohëzgjatje të rritur në vende pune dhe punë të cilat realizohen nën tokë dhe i cili gjatë sigurimit ka qenë ka qenë i sistemuar në punë dhe vende pune me shkallë të ndryshme të rritjes së stazhit të sigurimit, mund ta fitojë të drejtën e pensionit të pleqërisë me mbushjen e 40 viteve stazh pensional (mashkull), përkatësisht 35 vjet stazh pensional (femër)."

Neni 3

Në nenin 31 paragrafi (2) pas fjalëve: "bujqit individualë" shtohen fjalët: "dhe personit fizik që është i regjistruar si kryerës i veprimtarisë së pavarur për tregti me pakicë në tezga dhe tregje".

Neni 4

Në nenin 38 paragrafi (6) pas fjalëve: "bujkut individual" shtohen fjalët: "dhe personit fizik që është i regjistruar si kryerës i veprimtarisë së pavarur për tregti me pakicë në tezga dhe tregje".

Neni 5

Në nenin 118 paragrafi (1) pas numrit "14" shtohen fjalët: "dhe 15".

Neni 6

Në nenin 125 paragrafi (4) pas pikës 5) shtohet pikë e re 6), si vijon:

"6) Oda e Tregtarëve të Maqedonisë për personat nga neni 11 paragrafi (1) pika 15) e këtij ligji,".

Pika 6) bëhet pikë 7).

Neni 7

Në nenin 160 pika 6) ndryshohet si vijon:

“6) posedon një prej certifikatave ose vërtetimeve të njohura ndërkombëtare për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vite:

- TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
- IELTS - së paku 6 pikë,
- ILEC (Cambridge English: Legal) së paku niveli B2,
- FCE (Cambridge English: First) – të dhënë,
- BULATS – së paku 60 pikë ose
- APTIS – së paku niveli B2.”.

Pika 7) shlyhet.

Neni 8

Në nenin 199 pika 6), pika në fund të fjalisë zëvendësohet me pikëpresje dhe shtohet pikë e re 7), si vijon:

“7) Oda e Tregtarëve të Maqedonisë – për person fizik i cili është i regjistruar si kryerës i veprimtarisë së pavarur për tregti me pakicë në tezga dhe tregje.”.

Neni 9

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor.

Neni 10

Dispozitat nga neni 2 i këtij ligji, me të cilat plotësohet neni 19 me paragraf të ri (3), do të fillojnë të zbatohen nga 1 dhjetori 2018.

Neni 11

Procedurat e filluara nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, e të cilat kanë të bëjnë me përfshirjen me sigurim të detyrueshëm pensional dhe invalidor të bujqve individualë nga Ligji për sigurim pensional dhe invalidor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16 dhe 35/18), do të përfundojnë në pajtim me ligjin sipas të cilit kanë filluar.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.